

UNIVERSITETI I TETOVËS

Drejtuar:

Këshilli Mësimor- Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore

Në bazë të neni 170, të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore- shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të Statutit të Universitetit të Tetovës, si dhe në bazë të procesverbalit (nr.15-648/1) në mbledhjen e mbajtur më datë 16.04.2021 të Këshillit profesional të programit studimor Informatikë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në lidhje me konkursin për zgjedhje të shpallur me datën 07.04.2021 në gazetata ditore “Koha” dhe “Slloboden Peçat” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshillit Mësimor-Shkencor në mbledhjen e mbajtur më datë 22.04.2021 sjell: Vendimin (nr. 15-679/1) për formimin e komisionit recensues. Formohet komisioni për zgjedhje të një asistent për lëndët mësimore në fushën e informatikës në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Florim Idrizi – kryetar**
- 2. Prof. Dr. Eip Rufati - anëtar**
- 3. Prof. Dr. Agon Memeti – anëtar**

Në konkursin e shpallur më date 07.04.2021 në gazetata ditore “Koha” dhe “Slloboden Peçat” dhe në Ueb faqen e Universitetit të Tetovës, janë paraqitur dy kandidat:

- **Mr. Sc. Naser Mislimi** - e angazhuar në kontratë (Part – Time) në Programin studimor Informatikë, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, në Universitetin e Tetovës.
- **Mr.sc. Elham Hamiti** – i punësuar si Senior Developer and Team Lead në Ecolog international

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati në fjalë, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, e paraqetë këtë:

REFERAT

Për zgjedhje e një asistenti për lëndët mësimore në fushën e informatikës, pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës

Shënime biografike të kandidatit Naser Mislimi

Kandidati Naser Mislimi u lind më 17.04.1972 në f.Molvë komuna Gjurgjevac – Kroaci. Për momentin jeton dhe banon në f.Strimnicë, komuna e Zhelinës qyteti i Tetovës.

Studimet e ciklit të parë i kreu në vitin 2002 në Universitetin e Tetovës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor të Informatikës, me temë diplome “**Mikroprocesorët CISC dhe RISC**” me notë maksimale 10 të diplomës si dhe me notë mesatare 8.83 të studimeve, ku fiton titullin **Inxhinier i Diplomuar i Informatikës**.

Studimet e ciklit të dytë i kreu në vitin 2017 në Universitetin Jug-Perëndimor “Neofit Rilski” Blagoevgrad, Bullgari, Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore në Programin e Informatikës, me tezë “**Aplikacioni mobil për rezervimin e biletave të linjës ajrore bazuar në sistemin operativ Android**” me notë mesatare 8.64 të studimeve, me çka edhe fiton titullin **Magjistër i Informatikës**.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si asistent Part-Time në Programin studimor të Informatikës nga viti 2002-2009. Gjithashtu pas mbarimit të studimeve të ciklit të dytë rikthehet përsëri dhe nga viti 2018 angazhohet si asistent Part-time në Universitetin e Tetovës, në FSHMN, katedra e Informatikës.

Përvoja profesionale

Kandidati Naser Mislimi ka qenë drejtor gjeneral i firmës “Master Computers” nga viti 2001 deri në vitin 2015, më pas vazhdon si administrator kryesor në firmën TetovaSot-Media për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e portalit www.tetovasot.com.

Si drejtor në firmën “Master Computers” ka punuar edhe me servise të kompjuterëve, shitje, dhe ka mbajtur kurse në lëmine e Informatikës (Corel, Photoshop, C++, Microsoft Office, Windows, Rrejta, etj).

Gjuha shqipe është gjuha amtare, megjithatë fletë rrjedhshëm edhe gjuhën maqedone dhe gjuhën angleze. Ka njohuri në dizajnimin dhe implementimin e bazave të të dhënave (SQL Server, MySQL, MS Access), ka aftësi të mira në sferën e programimit, njohje e mirë e gjuhës programore C# (konsollë, windows dhe web aplikacionet), gjuhët programore C++, PHP, Python, njohuri të mira në HTML, CSS, Java Programim, WordPress.

Veprimtaria mësimore-arsimore

Nga viti 2002- 2021 angazhohet si asistent-ligjerues në lëndët:

- Bazat e Informatikës 2002-2004, Fakulteti Filologjik (Gjuhë Angleze, Frengje dhe Shqipe).
- Bazat e Informatikës 2002-2004, Fakulteti Shkencave Mjekësore (Mjekësi, Stomatologji).
- Bazat e Informatikës 2002-2004, Fakulteti Ekonomik.

- Bazat e Informatikës 2007-2009, Fakulteti Juridik
- Bazat e Informatikës 2002-2004, 2007-2009 FSHMN, drejtimi Informatikë Profesionale.
- Sistemet Operative 2002-2004, 2007-2009 FSHMN, drejtimi Informatikë Profesionale.
- Arkitektura Kompjuterike 2002-2004, 2007-2009, FSHMN, drejtimi Informatikë Profesionale.
- Statistikë Mjekësore me Informatikë 2018-2021, FSHM, drejtimi Infermieri
- Arkitektura Kompjuterike dhe Sistemet Operative, 2018-2021, FSHMN, Informatikë Biznesi.
- Strukturat e të dhënave dhe Algoritmet , 2018-2021, FSHMN, Informatikë Biznesi.
- Informatika I 2018-2021, Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë – Agrobiznes.

Shënime biografike të kandidatit: Elham Hamiti

Kandidati Elham Hamiti u lind më 28.04.1989 në Gostivar. Studimet e ciklit të parë i kreu në vitin 2012 në Universitetin e Tetovës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor të Informatikës, me temë diplome **“Programming intelligent Applications”** (nuk ka dëshmi).

Studimet e ciklit të dytë i kreu në vitin 2015 në Universiteti i Evropës Juglindor, Drejtimi Zhvillimi i softuerit dhe Aplikacioneve me temë të magjistraturës **“Parallel Algorithms for Sorting and Implementation in CUDA”**

Poashtu, vijon studimet në ciklin e tretë, në Universitetin “Kirili dhe Metodij”, në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Informatike dhe Inxhinierise Kompjuterike (nuk ka dëshmi).

Përvoja profesionale

Kandidati Elham Hamiti nga viti 2010 -2012 ka punuar si Software developer në InfoEcc, Gostivar.

Nga 2013 – 2014 ka punuar në .Net Software developer në “EuroNetCom”, Shkup.

Nga 2014 – 2015 ka punuar në .Net Software developer në “EinSof”, Shkup.

Nga viti 2015 ne vazhdim i punësuar si “Senior Developer and Team Lead” në Ecolog international

Publikimet shkencore

- Elham Hamiti, Performance analysis of parallel end sequential Sorting Algorithms – Comparative study and implementation on different hardware platforms, 2nd International Conference Towards Sustainable Development (TSD’2018)
- Elham Hamiti, Agni Dika, Valdete Ameti, Creation and using and Intelligent Agent in education process.

Përfundim dhe propozim

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në konkursin e shpallur, kandidati Mr. sc. Naser Mislimi i plotëson kushtet ligjore edhe profesionale sipas nenit 170 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018)

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm të punës arsimore, kandidati ka pasur aktivitete të ndryshme dhe relevante nga lëmia e Shkencave të Informatikës dhe kompjuterike, notën mesatare gjatë studimeve të ciklit të parë dhe të dytë.

Komisioni recenzues i propozojnë Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore që kandidati **Mr. sc. Naser Mislimi** të zgjidhet në thirrjen Mësimore - Shkencore **ASISTENT** për lëndët mësimore në fushën e informatikës.

Tetovë, 10.05.2021

Komision recenzues:

1. **Prof. Dr. Florim Idrizi** – kryetar
2. **Prof. Dr. Eip Rufati** – anëtar
3. **Prof. Dr. Agon Memeti** – anëtar